

DOMOSDOSHMERIA E RIINTEGRIMIT FËMIJËT E KTHYER NË BALLKANIN PERËNDIMOR

ADRIAN SHTUNI

SERIA E BALLKANIT PERËNDIMOR

“Kërkimet dhe programet e kohëve të fundit për të kthyerit nga Siria dhe Iraku kanë filluar rishtas të adresojnë sfidën e kthimit të të miturve.”

DISA FAKTE

- Në total, rreth 500 luftëtarë të huaj dhe familjarë të tyre nga Ballkani Perëndimor ndodhen ende në Siri dhe Irak.
- Numri i pretenduar i luftëtarëve meshkuj përbën rreth një të tretën e individëve nga Ballkani Perëndimor që ndodhen ende në Siri. Fëmijët përbëjnë rreth dy të tretat dhe gratë një pakicë të vogël.
- Demografia aktuale e të rinjve të huaj të prekur nga konflikti në Siri kërkon ndërhyrje proaktive, konsideratë të veçantë të moshës dhe gjinisë dhe përshtatje të duhura të politikave të reagimit për t'i paraprirë riatdhesimit të tyre.

Konteksti

Që prej vitit 2012, 1070 shtetas nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë udhëtuar për të jetuar dhe luftuar në territoret e kontrolluara nga organizatat terroriste në Siri dhe Irak. Rreth 200 syresh kanë qenë të mitur në kohën e nisjes. Me kalimin e viteve, në arenën e konfliktit në Siri dhe Irak, kanë lindur një numër edhe më i madh fëmijësh të shtetasve të Ballkanit Perëndimor. Në fund të vitit 2019, rreth 485 individë ishin kthyer në shtëpi, duke e bërë Ballkanin Perëndimor rajonin me përqendrimin më të lartë të të kthyerve nga Siria dhe Iraku në Evropë.¹ Qindra të tjerë, kryesisht të mitur, mbeten të bllokuar në Siri në kushte të rrezikshme, me

1 SHËNIM: Për më shumë të dhëna dhe për një vlerësim të hollësishëm të gjendjes aktuale të kontingjentit të luftëtarëve të huaj dhe familjarëve të tyre nga Ballkani Perëndimor, shihni: Adrian Shtuni, “Western Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications, Combating Terrorism,” *CTC Sentinel* 12, no. 7 (13 gusht 2019):18-24, <https://ctc.usma.edu/western-balkans-foreign-fighters-homegrown-jihadis-trends-implications/>.

perspektiva të pasigurta riatdhesimi.² Shumë shtete po hasin vështirësi në vendimmarrjen e tyre lidhur me trajtimin e shtetasve që kanë udhëtuar për të jetuar dhe luftuar në të ashtuquajturin "kalifat" të Shtetit Islamik (IS). Megjithatë, përvoja dhe të kuptuarit e faktorëve që lehtësojnë angazhimin efektiv me të kthyerit nga Siria, e veçanërisht me fëmijët e kthyer, është ende në fazat e hershme. Kjo Notë Politike ofron rekomandime mbi qasjet alternative ndaj rehabilitimit dhe riintegrimin (R&R) të fëmijëve të kthyer në Ballkanin Perëndimor, duke ndërthurur praktikatat e mira të kohëve të fundit me parimet orientuese të konventave, traktateve dhe protokolleve që fokusohen te të drejtat e fëmijëve.

Detention Camps, Initial Repatriations, & Ongoing Challenges

Pas rënies së "kalifatit" fizik të IS-it, dhjetëra mijëra luftëtarë të dorëzuar dhe familjarë të tyre po mbahen në burgjet e mbipopulluara kurde dhe në kampet e Personave të Shpërngulur Brenda Vendit (IDP). Kampi Al-Hol, me numrin më të madh të familjarëve të luftëtarëve të IS-it, strehonte 68 823 persona në gusht 2019³— ai ishte projektuar fillimisht për të sistemuar rreth shtatë herë më pak njerëz.⁴ Një raport i hartuar rishtas i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për Drejtat e Njeriut i përshkruante kushtet në Al-Hol si "të mjerueshme dhe çnjerëzore".⁵ Nga popullsia totale e Al-Hol-it, rreth 7000 janë të mitur të huaj dhe rreth 3000 janë gra të huaja nga rreth 50 vende⁶— duke përfshirë qindra nga Ballkani Perëndimor.

Në total, rreth 500 luftëtarë të huaj dhe familjarë të tyre nga Ballkani Perëndimor ndodhen ende në Siri dhe Irak. Numri i pretenduar i luftëtarëve meshkuj përbën rreth një të tretën e këtij kontingjenti nga Ballkani Perëndimor, ndërsa fëmijët përbëjnë rreth dy të tretat dhe gratë një pakicë të vogël. Shumë prej këtyre luftëtarëve dhe familjarëve të tyre dëshirojnë të kthehen në vendet e tyre të origjinës.

Deri më tani, shumë qeveri kanë hezitur të riatdhesojnë qytetarët e tyre për shkak të vështirësive teknike dhe ligjore, faktorëve politikë dhe problemeve të sigurisë.⁷ Shtetet evropiane si Franca, Gjermania, Holanda, Norvegjia dhe Belgjika kanë vendosur të riatdhesojnë - pothuajse ekskluzivisht - vetëm disa fëmijë jetimë të shtetasve të tyre që iu bashkuan IS-it. Deri më tani, Kosova është një ndër të paktat vende në Evropë që ka pranuar riatdhesimin në grup të 110 shtetasve, mbi dy të tretat (74) e të cilëve janë fëmijë, duke përfshirë ata të lindur nga të paktën një prej shtetasve të saj në Siri dhe Irak.⁸ Në fund të

2 Po aty

3 Syrian Arab Republic: North East Syria: Al Hol Camp," *OCHA*, 1 gusht 2019, <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/Al-Hol-Snapshot-SitRip-040819.pdf>.

4 Keerthana Annamaneni, "For ISIS Children, Returning Home to Europe Meets Resistance," *The New York Times*, 15 gusht 2019, <https://www.nytimes.com/2019/08/15/world/europe/isis-children-belgium.html>.

5 Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Hetimin mbi Sirinë, *Escalating Violence and Waves of Displacement Continue to Torment Civilians during Eighth Year of Syrian Conflict* (Gjenevë: Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 2019), <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/Faqes/NewsDetail.aspx?NewsID=24972&LangID=E>.

6 Po aty

7 Michael Birnbaum, "Months after the Fall of ISIS, Europe Has Done Little to Take Back Its Fighters," *The Washington Post*, 20 qershor 2019, https://www.washingtonpost.com/world/europe/after-caliphate-collapsed-europe-has-done-little-to-take-back-those-who-joined-isis/2019/06/20/4bab9cc2-8bc4-11e9-b6f4-033356502dce_story.html.

8 Fatos Bytyci, "Kosovo Brings Back Fighters, Families of Jihadists from Syria," *Reuters*, 20 prill 2019, <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-syria/kosovo-brings-back-fighters-families-of-jihadists-from-syria-idUSKCN1RW003>.

dhjetorit 2019, Bosnjë dhe Hercegovina riatdhesoi gjithashtu 25 shtetas të saj, 12 prej të cilëve ishin fëmijë.⁹ Ndërsa 25 shtetas boshnjakë të riatdhesuar përbëjnë vetëm një të dhjetën e numrit total të shtetasve boshnjakë në kampet siriane – që mendohet të jetë 260 sipas burimeve zyrtare¹⁰— riatdhesimi i tyre është mjaft me rëndësi. Gatishmëria e Kosovës dhe Bosnjës, dy vende të vogla dhe me burime modeste, për të lehtësuar kthimin e shtetasve të tyre dhe veçanërisht të fëmijëve, sinjalizon se, pavarësisht vështirësive të shumta objektive, është më se e mundur të gjendet vullneti politik për të adresuar këtë çështje delikate për Ballkanin Perëndimor.

Megjithatë, vendet e tjera në rajon kanë shfaqur ngurrim për të siguruar kthimin e shtetasve të tyre ose u mungojnë planet për realizimin e tij. Deri më tani, asnjë vend tjetër i Ballkanit Perëndimor nuk ka bërë publik ndonjë plan ose afat kohor për riatdhesim. Mbetet e paqartë nëse ka një strategji për të adresuar këtë sfidë komplekse. Kampet dhe burgjet e improvizuara kurde nuk do të japin zgjidhje afatgjatë për këtë çështje të ngutshme, veçanërisht nëse marrim parasysh se kontingjenti i të huajve që mbahen në to përbëhet kryesisht nga të mitur vulnerabël, të nënshtruar ndaj kushteve të vështira që i hapin rrugë radikalizimit.¹¹ Demografia aktuale e të rinjve të huaj të prekur nga konflikti në Siri kërkon ndërhyrje proaktive, konsideratë të veçantë të moshës dhe gjinisë dhe përshtatje të duhura të politikave të reagimit për t'i paraprirë riatdhesimit të tyre. Kjo vlen sidomos për Ballkanin Perëndimor, i cili ka një numër më të madh të të kthyerve ose të personave me mundësi riatdhesimi, por një nivel shumë më të ulët burimesh, kapacitetesh dhe ekspertize për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë efektive, krahasuar me shumicën e shteteve të tjera evropiane.

Rekomandime

Kërkimet dhe programet e kohëve të fundit për të kthyerit nga Siria dhe Iraku kanë filluar rishtas të adresojnë sfidën e kthimit të të miturve. Programet e përshtatura sipas moshës dhe faktorëve gjinorë mbeten të rralla. Ndonëse përvoja e angazhimit efektiv me fëmijët e kthyer nga Siria dhe Iraku është në fazat e saj të hershme, po dalin gradualisht në pah praktikatat e para të mira nga përpjekjet për kthim dhe riintegrim (R&R).¹² Kërkimet e dobishme dhe praktikatat e mira nga puna rehabilituese me ushtarët e mitur ose të miturit e ekspozuar ndaj traumave të lidhura me luftën mund të sigurojnë informacion për hartimin e politikave efektive të reagimit për adresimin e kthimit dhe riintegrimin të fëmijëve të kthyer në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me konventat, traktatet dhe protokollet orientuese që parashikojnë të drejtat e fëmijëve.

Politikëbërja proaktive, transparente dhe gjithëpërfshirëse

- **Të miratojmë një qasje shumëpalëshe proaktive dhe gjithëpërfshirëse, duke ndjekur një strategji afatgjatë për kthimin dhe riintegrimin.** Autoritetet qeveritare duhet të investojnë në mënyrë proaktive në partneritete dhe programe shumëpalëshe të cilat të jenë fleksibël, me financim të mjaftueshëm dhe gjithëpërfshirëse, duke integruar shoqërinë civile që në fillësë të procesit. Donatorët ndërkombëtarë dhe agjencitë e specializuara duhet

9 “Authorities Say 25 Bosnians Sent Home from Camps in Syria,” *AP News*, 19 dhjetor 2019, <https://apnews.com/850b5ffb045c65f1dfbbce52c9ff182>.

10 “Bosnia: Citizens Who Fought for IS in Syria Can Return,” *AP News*, 11 nëntor 2019, <https://apnews.com/818776caf4a44b6f97d8eb5c285ace00>.

11 Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, *Report of the Independent International Commission of Inquiry on the Syrian Arab Republic*, A/HRC/42/51 (Nju Jork: Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2019), https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/a_hrc_42_51.pdf.

12 Për më shumë, shihni “Sugjerime për Lexim të Metejshtëm, sipas temës” në fund të kësaj Note Politike.

të japin fonde shtesë dhe të bëjnë përpjekje për zhvillimin e kapaciteteve për të adresuar mungesat në burime dhe ekspertizë. Me mbi 400 fëmijë dhe 150 gra të riadhesuara nga Siria dhe Iraku¹³ deri më sot, përpjekjet e Kazakistanit mund të shërbejnë si pikë referimi për këtë qasje. Deri në fund të vitit 2019, ky shtet kishte ngritur 17 qendra rajonale të pritjes dhe rehabilitimit¹⁴ për të strehuar të kthyerit për periudha të pakufizuara kohore, në varësi të nevojave individuale dhe progresit të çradikalizimit.¹⁵ Qendrat ofrojnë jo vetëm shërbime strehimi, por edhe trajtim mjekësor dhe psikologjik, edukim, asistencë ligjore, terapi përmes artit dhe formim profesional.¹⁶ Kurrikula është hartuar me pjesëmarrjen e një grupi OJF-sh, ndërsa nëpunësit socialë dhe agjencitë qeveritare koordinojnë zbatimin e programit.¹⁷

- **Të hartojmë protokolle angazhimi të përshtatura për të miturit e kthyer, duke i bërë ato publike dhe duke decentralizuar procesin e vënies së tyre në zbatim nëse është e mundur.** Një qasje angazhimi e përshtatur me nevojat e veçanta të të miturve ka gjasa të kontribuojë në një rehabilitim psikosocial më efektiv dhe në një riintegrim të përsheptuar të fëmijëve të kthyer. Publikimi i këtyre udhëzimeve do të siguronte rritje të transparencës, llogaridhënies dhe mbështetjes për procesin. Një qasje e decentralizuar e zbatimit, nën udhëheqjen e autoriteteve vendore dhe OJF-ve, mund të nxisë rritjen e angazhimit dhe marrjes përsipër të procesit të kthimit dhe riintegrimin në nivelin komunitar. Pavarësisht se deri në fillim të vitit 2020 Franca kishte riadhesuar vetëm 17 të mitur¹⁸, kryesisht jetimë, në fillim të vitit 2017 ajo hartoi dhe publikoi disa udhëzime dhe modalitete të detajuara për trajtimin e të miturve francezë dhe të huaj të riadhesuar që kthehen nga Siria dhe Iraku.¹⁹ Dokumenti strategjik thekson rolin udhëheqës të autoriteteve vendore dhe zyrave rajonale dhe përfshin një skemë për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive përgjegjëse për zbatimin e tij.
- **Të fokusohemi te pikëpamja e edukimit në krijimin e kuadrit dhe qasjes për kthimin dhe riintegrimin e fëmijëve të kthyer.** Për shkak të faktorëve që lidhen me sigurinë kombëtare, disa aspekte të riadhesimit dhe kthimit e riintegrimin të të kthyerve, veçanërisht të të rriturve, janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me veprimtarinë ligjzbatuese dhe drejtësinë penale. Sidoqoftë, për fëmijët, arsimit dhe formimi profesional janë ndër aspektet më të rëndësishme të kthimit dhe riintegrimin, pasi i hapin rrugë të ardhmeje të re, siç është rasti i programeve të riintegrimin të ushtarëve të mitur.²⁰ Duke

13 "Zhusan Operation: 595 Kazakhstanis Repatriated from Syria," *Kazinform International News Agency*, 6 shkurt 2020, https://www.inform.kz/en/zhusan-operation-595-kazakhstanis-repatriated-from-syria_a3611674.

14 Stevan Weine "Rehabilitating the Islamic State's Women and Children Returnees in Kazakhstan," *Just Security*, 12 dhjetor 2019, <https://www.justsecurity.org/67694/rehabilitating-the-islamic-states-women-and-children-returnees-in-kazakhstan/>.

15 "39 Families Have Been Returned Back from Syria to Kazakhstan," *Kazakhstan Today*, 18 nëntor 2019, https://www.kt.kz/eng/international_affair/39_families_have_been_returned_back_from_syria_to_kazakhstan_1153667282.html

16 Ksenia Bondal, "Kazakhstan Rehabilitating Children Recently Returned from Syria, Iraq," *Caravanserai*, 8 janar 2019, http://central.asia-ews.com/en_GB/articles/cnmi_ca/features/2019/01/08/feature-01.

17 Andrew E. Kramer, "Kazakhstan Welcomes Women Back from the Islamic State, Warily," *The New York Times*, 10 gusht 2019, <https://www.nytimes.com/2019/08/10/world/europe/kazakhstan-women-islamic-state-deradicalization.html>.

18 Benjamin Sportouch dhe Charles Deluermoz, "Enfants de jihadistes: 'Nous en avons rapatrié 17' en France, annonce Le Drian sur RTL," *RTL*, 2 shkurt 2020, <https://www.rtl.fr/actu/politique/enfants-de-jihadistes-nous-en-avons-rapatrie-17-en-france-annonce-le-drian-sur-rtl-7800014980>.

19 Kryeministria e Qeverisë Franceze, *Instruction relative à la prise en charge des mineurs à leur retour de zone irako-syrienne*, Qarkore Nr. 5923/SG (Paris: Qeveria Franceze, Mars 2017), http://circulaires.legifrance.gouv.fr/pdf/2017/03/cir_41965.pdf.

20 Zyra e Përfaqësuesit Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Fëmijët dhe Konfliktet e Armatosura, *Reintegration of Former Child Soldiers* (Nju Jork: Sekretariati i Kombeve të Bashkuara, 2018), <https://childrenandarmedconflict.un.org/wp-content/>

pasur parasysh këtë, ministritë përkatëse të arsimit të secilit vend të Ballkanit Perëndimor, për shembull, mund të jenë në pozita më të favorshme dhe të përshtatshme sesa ministritë e punëve të brendshme kur bëhet fjalë për udhëheqjen dhe koordinimin e rehabilitimit të fëmijëve të përfshirë në konflikte të ekstremizmit të dhunshëm. Zgjedhja e ministrisë përgjegjëse është e rëndësishme, pasi ajo pasqyron dhe përcjell te publiku mendësinë e përgjithshme të angazhimit të qeverisë. Në Kazakistan, qeveria vendosi të caktonte Ministrinë e Arsimit në krye të programit të kthimit dhe rehabilitimit. Në këtë drejtim, përvoja e Kazakistanit mund të shërbejë si një pikë e vlefshme referimi.²¹

Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijës

- **Të mbështesim masat që i japin përparësi interesit më të lartë të fëmijëve të kthyer dhe një kthimi dhe riintegrimi sa më të shpejtë në shoqëri.** Institucionet gjyqësore duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe standardet në fuqi të drejtësisë për të mitur. Në rastet kur lejohet ndjekja penale e fëmijëve nën 18 vjeç, duhet të merren në konsideratë alternativa të tjera ndaj paraburgimit dhe burgimit, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.²² Rezoluta 70/291 e Asamblesë së Përgjithshme "Për rishikimin e Strategjisë Globale të Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit", e adreson këtë çështje të veçantë dhe duhet të konsultohet gjatë hartimit të mekanizmave të duhur ligjorë.²³
- **Të kryejmë vlerësime të rrezikut dhe nevojave për të vlerësuar mirëqenien mendore të fëmijës së kthyer dhe nivelin e traumës para se të ofrojmë mbështetje psikosociale të përshtatur sipas nevojave individuale.** Fëmijët e kthyer janë ekspozuar ndaj akteve të dhunës ekstreme dhe, në disa raste, mund të kenë qenë edhe vetë viktimat të kësaj dhune. Në raste të tjera, ata mund të kenë marrë pjesë në kryerjen e akteve ekstremiste të dhunshme. Agjencitë përgjegjëse për shëndetin publik duhet të kryejnë vlerësime të hollësishme dhe periodike për të vlerësuar secilin rast individualisht.²⁴ Meqenëse disa nga fëmijët më të rritur në moshë mund t'i jenë nënshtruar indoktrinimit dhe stërvitjes nga ekstremistë të dhunshëm gjatë qëndrimit në Siri dhe Irak, autoritetet duhet të vlerësojnë rrezikshmërinë e tyre të mundshme dhe të ofrojnë kujdes të specializuar për të adresuar indoktrinimin dhe stërvitjen e tyre, para se t'i transferojnë në institucione arsimore publike. Në fund të prillit 2019, Kosova riatdhesoi 74 të mitur nga Siria. Në shtator, të gjithë fëmijët e moshës shkollore mes personave të kthyer ishin

[uploads/2018/09/Reintegration-brochure-layout.pdf](https://www.gkss.org/repository/docs/violent-extremism-eng_978757.pdf); Skënder Perteshi dhe Ramadan Ilazi, *Unpacking Kosovo's Response to Returnees from the War Zones in Syria and Iraq* (Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020), http://www.gkss.org/repository/docs/violent-extremism-eng_978757.pdf.

21 Weine, "Rehabilitating the Islamic State's Women and Children Returnees in Kazakhstan."

22 *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve* (Nju Jork: Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1989), <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/faqs/crc.aspx>; Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Terrorizmit (UNCCT), *Children Affected by the Foreign-fighter Phenomenon: Ensuring a Child Rights-based Approach* (Nju Jork: UNCCT, 2019), https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/ftf_handbook_web_reduced.pdf.

23 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Sesioni i 70-të, "Rezoluta 70/291 [Rishikimi i Strategjisë Globale Kundër Terrorizmit i Kombeve të Bashkuara]" (A/RES/70/291) 1 korrik 2016, <https://www.un.org/sc/ctc/news/document/a-res-70-291-the-united-nations-global-counter-terrorism-strategy-review/>.

24 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), *Non-custodial Rehabilitation and Reintegration in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism A Guidebook for Policymakers and Practitioners in South-Eastern Europe* (Vjenë, OSBE, 2020), <https://www.osce.org/secretariat/444838?download=true>.

gati për të filluar shkollën.²⁵ Duke qenë se përfshirja e tyre efektive në shoqëri është qëllimi përfundimtar i përpjekjeve për riintegrim, regjistrimi i fëmijëve të kthyer është një hap pozitiv. Megjithatë, mbetet e paqartë se çfarë niveli mbështetjeje të personalizuar psikologjike dhe akademike u është ofruar këtyre fëmijëve përpara regjistrimit të tyre në shkollat publike pak muaj pas kthimit.

- **Të kryejmë teste psikometrike për të vlerësuar zhvillimin intelektual të fëmijëve të kthyer, në mënyrë që të bëhet kategorizimi i tyre i duhur në sistemin arsimor dhe t'u ofrohet ndihmë akademike sipas nevojës.** Këto përpjekje kanë gjasa të jenë më efektive nëse fëmijët nuk institucionalizohen, por marrin formim akademik dhe ndihmë psikologjike në shtëpi, mundësisht nga ekipe të lëvizshme ekspertësh. Kjo mund të ndihmojë në shmangien e ndjenjave të papërshtatshmërisë, stigmatizimit dhe marginalizimit të mundshëm, derisa të kthyerit të arrijnë të mësohen me mjedisin e ri shoqëror. Në Francë, për shembull, pasi prokurori dhe gjykatësi për të mitur vlerësojnë rastin e një fëmije të kthyer, të miturit u nënshtrohen një ekzaminimi fizik dhe psikologjik nën kujdesin e shërbimeve sociale. Vendimet për shkollimin merren në konsultim midis Drejtuesit Akademik të Shërbimeve Kombëtare të Arsimit, institucioneve arsimore dhe profesionistëve që zbatojnë dhe monitorojnë përpjekjet për kthim dhe riintegrim.²⁶

Përfundimi

Për ta përmbledhur, rehabilitimi dhe riintegrimi i suksesshëm i fëmijëve të kthyer do të kërkojë miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të mbështetjes psikosociale, që adreson të gjitha aspektet e ndërveprimit shoqëror dhe riintegrimin të tyre në familje, shkollë dhe komunitet. Si i tillë, progresi i secilit fëmijë në procesin e kthimit dhe riintegrimin do të ndikohet ndjeshëm nga botëkuptimi dhe qëndrimi i prindërve dhe të afërmeve që jetojnë me ta. Prandaj, programet duhet të ofrojnë një mbështetje më të gjerë për të adresuar çështjet e radikalizimit për shkak të dhunës dhe traumave brenda familjes. Gjithashtu, mësuesit dhe profesionistët e tjerë të përfshirë në procesin e arsimimit dhe rehabilitimit të fëmijëve të kthyer duhet të trajnohen lidhur me ndërgjegjësimin për traumat dhe të informohen mbi procesin e radikalizimit, duke përfshirë edhe mënyrën e reagimit ndaj shenjave të sjelljeve shqetësuese dhe burimet ku mund të kërkojnë mbështetje të mëtejshme. Me përmirësimin e njohurive, aftësive dhe mjeteve për të adresuar shqetësimet e komuniteteve pritëse dhe realitetin e përvojave të të kthyerve, shtetet e Ballkanit Perëndimor mund të sigurojnë një riintegrim më të lehtë e të sigurt të këtyre personave në shoqëri.

25 Taulant Qenaj, "Fëmijët e Kthyer Nga Siria, Sërish Në Shkollë," *Radio Evropa e Lirë*, 27 gusht 2019, <https://www.evropaelire.org/a/femijet-e-kthyer-nga-siria-shkollim-/30130050.html>.

26 Kryeministria e Qeverisë Franceze, *Instruction relative à la prise en charge des mineurs à leur retour de zone irako-syrienne*, Qarkore Nr. 5923/SG.

Sugjerime për Lexim të Metejshëm, sipas temës

Për rekrutimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve nga terroristët

Bloom, Mia, me John Horgan. *Small Arms: Children and Terrorism*. Ithaca, Nju Jork: Cornell University Press, 2019.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC). *Handbook on Children Recruited and Exploited by Terrorist and Violent Extremist Groups: The Role of the Justice System*. Vjenë: UNODC, 2017. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Child-Victims/Handbook_on_Children_Recruited_and_Exploited_by_Terrorist_and_Violent_Extremist_Groups_the_Role_of_the_Justice_System.E.pdf.

Për Fëmijët e Lidhur me Organizatat Terroriste në Siri dhe Irak

Cook, Joana, dhe Gina Valle. "From Daesh to 'Diaspora' II: The Challenges Posed by Women and Minors After the Fall of the Caliphate." *kCTC Sentinel* 12, nr. 6 (korrik 2019): 30-45. (korrik 2019) <https://ctc.usma.edu/daesh-diaspora-challenges-posed-women-minors-fall-caliphate/>.

Për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve

Meines, Marije, Merel Molenkamp, Omar Ramadan, dhe Magnus Ranstorp. *RAN Manual: Responses to Returnees: Foreign Terrorist Fighters and their Families*. Amsterdam: Radicalisation Awareness Network (RAN) Centre of Excellence, 2017. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ran_br_a4_m10_en.pdf.

The Global Counterterrorism Forum (GCTF). *Good Practices on Addressing the Challenge of Returning Families of Foreign Terrorist Fighters*. GCTF, 2018. https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/2018/GCTF-Good-Practices-on-Returning-Families-of-FTFs_ENG.pdf?ver=2018-09-25-101427-323.

Kombet e Bashkuara. *Key Principles for the Protection, Repatriation, Prosecution, Rehabilitation and Reintegration of Women and Children with Links to United Nations Listed Terrorist Groups*. Kombet e Bashkuara, 2019. https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/Key%20Principles%20-%20April%202019_0.pdf.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Terrorizmit (UNCCT). *Children Affected by the Foreign-fighter Phenomenon: Ensuring a Child Rights-based Approach*. Nju Jork: UNCCT, 2019. https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/ftf_handbook_web_reduced.pdf

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC). *Roadmap on the Treatment of Children Associated with Terrorist and Violent Extremist Groups*. Vjenë: UNODC, 2019. <https://indd.adobe.com/view/61793921-8dc6-4fc2-9e46-b27c6390ff2>.

van der Heide, Liesbeth, dhe Jip Geenen. *Children of the Caliphate: Young IS Returnees and the Reintegration Challenge*. Hagë: Qendra Ndërkombëtare për Luftën kundër Terrorizmit - Hagë, 2017. <https://icct.nl/wp-content/uploads/2017/08/ICCT-vanderHeide-Geenen-Children-of-the-Caliphate-2.pdf>.

Për sfidat me të cilat përballen profesionistët që punojnë me fëmijët e kthyer

Radicalisation Awareness Network (RAN). *Child Returnees from Conflict Zones*. Amsterdam: RAN Centre of Excellence, 2016. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_child_returnees_from_conflict_zones_112016_en.pdf.

Burimet

"39 Families Have Been Returned Back from Syria to Kazakhstan." *Kazakhstan Today*, 18 nëntor 2019. https://www.kt.kz/eng/international_affair/39_families_have_been_returned_back_from_syria_to_kazakhstan_1153667282.html.

Annamaneni, Keerthana. "For ISIS Children, Returning Home to Europe Meets Resistance." *The New York Times*, 15 gusht 2019. <https://www.nytimes.com/2019/08/15/world/europe/isis-children-belgium.html>.

"Authorities Say 25 Bosnians Sent Home from Camps in Syria." *AP News*, 19 dhjetor 2019. <https://apnews.com/850b5ffbb045c65f1dfbbce52c9ff182>.

Birnbaum, Michael. "Months after the Fall of ISIS, Europe Has Done Little to Take Back Its Fighters." *The Washington Post*, 20 qershor 2019. https://www.washingtonpost.com/world/europe/after-caliphate-collapsed-europe-has-done-little-to-take-back-those-who-joined-isis/2019/06/20/4bab9cc2-8bc4-11e9-b6f4-033356502dce_story.html.

Bondal, Ksenia. "Kazakhstan Rehabilitating Children Recently Returned from Syria, Iraq." *Caravanserai*, 8 janar 2019. http://central.asia-ews.com/en_GB/articles/cnmi_ca/features/2019/01/08/feature-01.

"Bosnia: Citizens Who Fought for IS in Syria Can Return." *AP News*, 11 nëntor 2019. <https://apnews.com/818776caf4a44b6f97d8eb5c285ace00>.

Bytyci, Fatos. "Kosovo Brings Back Fighters, Families of Jihadists from Syria." *Reuters*, 20 prill 2019. <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-syria/kosovo-brings-back-fighters-families-of-jihadists-from-syria-idUSKCN1RW003>.

Kramer, Andrew E. "Kazakhstan Welcomes Women Back from the Islamic State, Warily." *The New York Times*, 10 gusht 2019. <https://www.nytimes.com/2019/08/10/world/europe/kazakhstan-women-islamic-state-deradicalization.html>.

Office of the Special Representative of the Secretary-General for Children and Armed Conflict. *Reintegration of Former Child Soldiers*. Nju Jork: Sekretariati i Kombeve të Bashkuara, 2018. <https://childrenandarmedconflict.un.org/wp-content/uploads/2018/09/Reintegration-brochure-layout.pdf>.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). *Non-custodial Rehabilitation and Reintegration in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism A Guidebook for Policymakers and Practitioners in South-Eastern Europe*. Vjenë, OSBE, 2020. <https://www.osce.org/secretariat/444838?download=true>.

Perteshi, Skënder, dhe Ramadan Ilazi. *Unpacking Kosovo's Response to Returnees from the War Zones in Syria and Iraq*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020. http://www.qkss.org/repository/docs/violent-extremism-eng_978757.pdf.

Kryeministria e Qeverisë së Francës. *Instruction relative à la prise en charge des mineurs à leur retour de zone irako-syrienne, Qarkore Nr. 5923/SG*. Paris: Qeveria e Francës, mars 2017. http://circulaires.legifrance.gouv.fr/pdf/2017/03/cir_41965.pdf.

Qenaj, Taulant. "Fëmijët e Kthyer Nga Siria, Sërish Në Shkollë." *Radio Evropa e Lirë*, 27 gusht 2019. <https://www.evropaelire.org/a/femijet-e-kthyer-nga-siria-shkollim-/30130050.html>.

Shtuni, Adrian. "Western Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications, Combating Terrorism." *CTC Sentinel* 12, no. 7 (13 gusht 2019):18-24. <https://ctc.usma.edu/western-balkans-foreign-fighters-homegrown-jihadis-trends-implications/>.

Sportouch, Benjamin, dhe Charles Deluermoz. "Enfants de jihadistes: 'Nous en avons rapatrié 17' en France, annonce Le Drian sur RTL." *RTL*, 2 shkurt 2020. <https://www.rtl.fr/actu/politique/enfants-de-jihadistes-nous-en-avons-rapatrie-17-en-france-annonce-le-drian-sur-rtl-7800014980>.

"Syrian Arab Republic: North East Syria: Al Hol Camp." *OCHA*, 1 gusht 2019. <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/Al-Hol-Snapshot-SitRip-040819.pdf>.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Hetimin mbi Sirinë. *Escalating Violence and Waves of Displacement Continue to Torment Civilians during Eighth Year of Syrian Conflict*. Gjenevë: Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 2019. <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/Fages/NewsDetail.aspx?NewsID=24972&LangID=E>.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve*. Nju Jork: Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1989. <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/fages/crc.aspx>.

— — —, Sesioni 70-të. "Resolution 70/291 [The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy Review]" (A/RES/70/291) 1 July 2016. <https://www.un.org/sc/ctc/news/document/a-res-70-291-the-united-nations-global-counter-terrorism-strategy-review/>.

Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. *Report of the Independent International Commission of Inquiry on the Syrian Arab Republic*, A/ HRC/42/51. Nju Jork: Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2019. https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/a_hrc_42_51.pdf.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Terrorizmit (UNCCT). *Children Affected by the Foreign-fighter Phenomenon: Ensuring a Child Rights-based Approach*. Nju Jork: UNCCT, 2019. https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/ftf_handbook_web_reduced.pdf.

Weine, Stevan. "Rehabilitating the Islamic State's Women and Children Returnees in Kazakhstan." *Just Security*, 12 dhjetor 2019. <https://www.justsecurity.org/67694/rehabilitating-the-islamic-states-women-and-children-returnees-in-kazakhstan/>.

"Zhusan Operation: 595 Kazakhstanis Repatriated from Syria." *Kazinform International News Agency*, 6 shkurt 2020. https://www.inform.kz/en/zhusan-operation-595-kazakhstanis-repatriated-from-syria_a3611674.

Rreth Notës

Autori: Adrian Shtuni, Drejtor Ekzekutiv i "Shtuni Consulting LLC", është specialist i politikës së jashtme, sigurisë dhe komunikimit strategjik me fokus rajonal në Ballkanin Perëndimor. Ai ofron shërbime konsultimi për agjencitë qeveritare të SHBA-ve, institucionet akademike dhe organizatat ndërkombëtare në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Azi, për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, rrezikut politik, propagandës së huaj dhe keqinformimit, si dhe kërcënimeve të tjera transkombëtare.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve. Ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Rrjetit "RESOLVE", Institutit të Paqes të SHBA-ve ose ndonjë organi qeveritar të SHBA-ve.

RRJETI "RESOLVE"

kërkim më i thelluar • praktikë e bazuar në informacion • politika të përmirësuar kundër ekstremizmit të dhunshëm •

www.resolvenet.org



"RESOLVE" e ka selinë në Institutin e Paqes të SHBA-ve dhe mbështetet në trashëgiminë dhjetëra vjeçare të angazhimit të thellë të Institutit në komunitetet e përfshira nga konflikti.



**UNITED STATES
INSTITUTE OF PEACE**
Making Peace Possible